

# Permbledhje Joteknike

E Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis  
per aktivitetin

« Kompostim i mbetjeve bio »



Vendodhja e ushtrimit te aktivitetit: Pasuria nr.82/9, Zona Kadastrale 2977, Pjetroshan, Koplk, Shkoder.

Subjekti : "MEIA" shpk

Administrator : Petrit Skora



## PERMBAJTJA

- Hyrje
- Informacion per qellimin e VNM dhe metodiken e zbatuar
- Pershkrimi i projektit
- Pershkrim i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi
- Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij
- Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit perfs hire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer
- Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime si dhe per prodhimin e mbetjeve
- Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara
- Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara qe perfsihen ne te
- Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin
- Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis
- Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar ( nese projekti ka natyre te tille)

## 1-HYRJE

Subjekti **MEIA** shpk është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më date 15/12/2010, me numër NIPT L02415007U dhe administrator Petrit Skora me objekt aktiviteti Prodhimi dhe eksportimi të esencave të bimeve etero-vajore e tanifere, grumbullim, perpunim dhe tregtim të bimeve etero-vajore, tanifere e mjekesore natyrale dhe të kultivuar etj.

Subjekti është i pajisur me Leje Mjedisore Tipi B me PN-0250-01-2021 , nr identifikimi 3247 date 27.01.2021, komision nr. 01 për aktivitetin “Trajtimi dhe perpunimi I materialeve të nevojshme për prodhimin e produkteve ushqimore nga lëndet e para vegjetale”, me vendodhje fshati Pjetroschan, Koplik, Shkoder.

Nga zhvillimi i aktivitetit të mesipër i grumbullimit dhe perpunimit të bimeve mjekesore natyrale dhe të kultivuar gjenerohen mbetje si kercej të bimeve, gjethe , lule të cilat dalin jashtë procesit të perpunimit , për të cilat shoqëria kërkon të zhvillojë aktivitetin e kompostimit të tyre në pasurinë me nr.82/9, Zona kadastrale 2977, me vendodhje në Pjetroschan, Koplik, Shkoder në një sipërfaqe totale prej 15595 m2.

Ku raport paraprak i vlerësimit të ndikimit në mjedis hartohet pikerisht për ndikimet në mjedis nga zhvillimi I aktivitetit të kompostimit të mbetjeve bio.

Raporti synon të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin mjedisor të projektit të propozuar në përdorimin e tokës, efektet lidhur me ndikimet në floren, faunen, burimet e ujit, shkarkimet në tokë, ujë, si dhe çdo ndikim social ekonomik në punësimin lokal, përmirësimin e infrastruktures dhe ndikimeve të tjera të rëndësishme mjedisore ose sociale, përfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësive dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet :

-Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit në fazën e përgatitjes së projektit.

-Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit.

-Të japë një gjendje sa më reale, nga pikepamja e ndikimit të aktivitetit mbi mjedisin human.

-Analizën e faktoreve pozitive e negative mjedisore, përcaktimin e masave zbutëse për reduktimin e ndikimeve negative.

-Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.

-Propozime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

Për këtë problem u bë mbikqyrja e terrenit në të gjithë zonën, duke kryer vërtetime të ndryshme , si dhe të biodiversitetit.

Në raport jepet statusi i territorit, korniza ligjore e tij, mjedisi biofizik, gjeologjia e rajonit, gjeologjia e zonës, hidrogeologjia.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk është i rëndësishëm vetëm për njëzëzit por është thelbësor dhe i nevojshëm për të gjitha qeniet në tokë. Njëzëzit duhet të kuptojnë se si përdorimi i burimeve mjedisore dhe përfitimet që vijnë nga ato të mos demtohen por të jete e mundur të përfitohet sot dhe në të ardhmen.

Termi mjedisi dhe burime natyrore përdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qartë që i perkufizon. Burimet natyrore i referohen burimeve të tokës, ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore, ajrit që rrethon tokën, çdo gjë që rritet në tokë apo det si dhe burimet që gjenden nëntokë si psh mineralet. Mjedisi është me gjithpërshires, çdo gjë që na rrethon.

Thjesht duke përdorur burimet natyrore në rrezikojmë në mbipërdorimin dhe shterimin e tyre. Shterimi i burimeve natyrore është një nga problemet thelbësor të çrregullimit të mjedisit. Në të përfshihet shterimi i ujit, mineraleve përfshirë dhe lëndet fosile si dhe shumë burime të tjera.

Çdo veprimtari kryer nga njeriu shoqërohet edhe me impakt në mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit të mjedisit natyror nga aktiviteti njerëzor.

Kemi dy tipe të impaktit mjedisor

- Shterimi i burimeve

- Ndotja

Në mënyrë që të shmangem këto probleme njëzëzimi duhet të mesoj se si të menaxhohen burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme. Pra zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore nuk është gjë tjetër veçse përdorimi i tyre në mënyrë ekonomike nga brezat e sotëm për të lënë këto burime të përdoren edhe nga brezat që do të vijnë.

Qëndrueshmëria përfshin menaxhimin e gjithë perberësve dhe burimeve natyrore e njëzëzore me qëllim që të pasurohen me kalimin e kohës dhe të sigurohet një mirëqenie për të gjithë. Zhvillimi i qëndrueshëm nuk i pranon politikat të cilat çojnë në uljen e bazës prodhuese dhe lënë gjeneratat e ardhshme me prespektiva më të ulta (të vërteta) dhe/ose rreziqe më të mëdha se të tonat. Teknologjitë që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm përfshijnë kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjisë së riciklueshme, rikuperimin e burimeve dhe riciklimin, menaxhimin e burimeve dhe kërkime shkencore.

## 2. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR

### a-Përshkrim të qëllimit dhe objektivave të VNM

Vlerësimi i ndikimit në mjedis është një proces në vazhdimësi i aktivitetit dhe siguron se ndikimet mjedisore të rëndësishme, sinjifikante janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë në mënyrë të kënaqshme në planifikim, projektim, zbatim të aktivitetit që do të zhvillohet.

### Qëllimi i VNM- se

Qëllimi i hartimit të raportit të VNM-se është përcaktimi i efekteve negative dhe pozitive të aktivitetit dhe masat e duhura për përmirësimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis si rezultat i zhvillimit të aktivitetit të kompostimit të mbetjeve bio. VNM nuk do të mbulojë çdo aspekt të një efekti mjedisor të projektit, me të njëjtin nivel detajesh. Thëksi do të vihet në ndikimet kryesore që shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu një synim tjetër është të percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative për zbutjen e anëve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit dhe të japë informacion për vendim-marrësit për pasojat mjedisore të aktiviteteve të propozuara.

VNM përfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet :

- Marrjes në konsideratë të ndikimeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
- Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit.
- Të japë një gjendje sa më reale, nga pikepamja e ndikimit në mjedis të aktivitetit mbi mjedisin human.
- Analizës së faktorëve pozitivë e negativë mjedisore dhe të masave zbutëse për reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimi cilësor me pika të ndikimeve në mjedis të projektit.
- Propozime të masave zbutëse të ndikimit në mjedis të projektit.

#### **Objektivat e VNM**

Objektivat e hartimit të VNM- së konsistojnë në evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve në mjedis dhe masat tekniko-organizative për një zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit, gjatë kryerjes së aktivitetit deri në përfundim të tij dhe rehabilitimin e hapësirës përreth objektit.

Me këtë studim informojmë organet vendim-marrëse, mbi ndikimet në mjedis dhe përfitimet e projektit të propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qëndrueshëm duke siguruar që zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mirëqenien, stilin e jetesës dhe jetesën e komunitet si dhe të njëzëve që lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

#### **Objektivat e tjera të studimit të paraqitur janë.**

- Përmirësimet mjedisore të zonës ku zbatohet projekti dhe rreth saj.
- Përdorimin e burimeve natyrore në mënyrën të qëndrueshme ku respektohen dhe kërkesat e komunitetit të zonës për rreth.
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale negative të projektit të zbatuar
- Lehtëson informimin e organeve vendim-marrëse, duke përfshirë vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore për zbatimin e projektit apo propozimit.
- Mbrojtjen e shëndetit të njeriut.
- Parashikon dhe përjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze të mjedisit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peziazhet e natyrës dhe komponentet përberëse të ekosistemeve.
- Përmirëson aspektet sociale të projektit.

**b) Përshkrim i përmblëdhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin**

Ne Shqipëri fillësat e legjislacionit mjedisor shfaqen në vitin 1993, vit në të cilin u hartua plani i parë i veprimit në fushën mjedisore, që përben dokumentin e parë zyrtar shqiptar mbi politikën mjedisore në vend. Ky plan veprimi kombëtar parashikonte se qeveria duhet të krijojë kuadrin ligjor, ekonomik dhe institucional për zgjidhjen e çështjeve mjedisore. Periudhen nga ky vit deri në miratimin e Kushtetutës në vitin 1998 mund të konsiderojmë si etapën e parë të zhvillimit të së drejtës shqiptare të mjedisit. Mbas vitit 1998 e në vijim është periudha e dytë e zhvillimit të së drejtës shqiptare të mjedisit, e cila ka si tipar kryesor prirjen e përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Europian për mjedisin. Kuadri ligjor mjedisor shqiptar është në përsosje dhe pasurim të vazhdueshëm dhe zhvillimi i tij nuk i është len rasteies, por ka si model dhe drejtues legjislacionin evropian të mjedisit. Duke qenë se kushtetutat ravigejzojnë drejtimit e rregullimeve të ardhshme dhe me të hollësisht që realizohen fillimisht me ligje dhe më pas me akte nënligjore edhe në rastin e vendit të Kushtetutës përben një fillesë dhe bazë të rëndësishme lidhur me rolin që ka mjedisi për shoqërinë dhe shtetin të tyre. Nisur nga përmbajtja e nënve të Kushtetutës lidhur me fushën mjedisore mund të pohojmë se fryma e Kushtetutës së tyre është në përputhje me atë të shumë kushtetutave të vendeve të tjera demokratike që u kushtojnë rëndësi të një niveli me të lartë disa parimeve mjedisore, duke i ngritur ato në nivelin e ligjit themelor të shtetit, sic janë e drejta për informimin e qytetarëve dhe angazhimi e përgjegjësia për një mjedis të përshtatshëm për të jetuar jo vetëm brezat e sotëm por edhe ata në të ardhmen.

- Ligji nr.52/2020 date 30.04.2020 për një ndryshim në ligjin nr. 10 448 date 14.07.2011 « Për Lejet e Mjedisit »
- Ligji nr.53/2020 date 30.04.2020 për një ndryshim në Ligjin Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Për Mbrojtjen e Mjedisit”
- VKM nr.686 date 29.7.2015 « Për miratimin e rregullave , të përgjegjësive e të afatëve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të Deklaratës Mjedisore »
- Ligji nr.128/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10440 date 07.07.2011 « Për vlerësimin e ndikimit në mjedis », të ndryshuar
- VKM nr. 435 date 12.09.2015 « Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë »
- VKM nr. 575 date 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A,B dhe C për transferimin e lejeve nga një subjekt të tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishtme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në leshimin e këtyre lejeve nga QKJja.
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”
- VKM nr. 229 date 23.04.2014 “ Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.
- VKM nr.371 date 11.06.2014 ‘Për përcaktimin e rregullave për dorezimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorezimit të mbetjeve të rrezikshme”
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

- Ligj nr. 10266 date 15.04.2010 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja" per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 8897 dt. 16.05.2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja"
- VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse".

### c) Pershkrim i metodikes te zbatuar per hartimin e raportit te vnm

Studimi i vleresimit te ndikimit ne mjedis u orientua nga rendesia dhe madhesia e projektit, vendi ku ai do te zhvillohet , pasurite natyrore dhe humane te zones si dhe vlerat e vecanta te tyre ne identifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutese duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike te investitorit dhe masat orientuese pas mbylljes se projektit.

Reduktimi i ndikimeve negative eshte nderthurur edhe me ndikime te rendesishme pozitive sidomos ne perfitime direkte dhe indirekte mbi komunitetin.

#### Studimi strukturohet ne kater faza kryesore :

- 1.Ngritja e objektivave orientuese te V.N.M.
- 2.Mbledhja e materialit baze ekzistues dhe atij te formuluar enkas per kete projekt dhe seleksionimi i tyre per perdorim.
- 3.Verifikimi ne terren i te dhenave ekzistuese dhe mbledhja e te dhenave te mundeshme biofizike dhe humane.
- 4.Hartimi i projektit bazuar ne legjislacionin Shqiptar si dhe kerkesave te organeve vendim-marrese dhe kontrollues te objekteve mjedisore ne nivel kombetar dhe lokal.

## 2-PERSHKRIM I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

### - Qellimi i projektit

Subjekti është i pajisur me Leje Mjedisore Tipi B me PN-0250-01-2021 , nr identifikimi 3247 date 27.01.2021, komision nr. 01 per aktivitetin "Trajtimi dhe perpunimi I materialeve te nevojshme per prodhimin e produkteve ushqimore nga lendet e para vegjetale", me vendodhje fshati Pjetroschan, Koplik, Shkoder.

Nga zhvillimi i aktivitetit te mesiperm i grumbullimit dhe perpunimit te bimeve mjekesore natyrale dhe te kultivuar gjenerohen mbetje si kercej te bimeve, gjethe , lule te cilat dalin jashte procesit te perpunimit , per te cilat shoqeria kerkon te zhvilloj aktivitetin e kompostimit te tyre ne pasurine me nr.82/9, Zona kadastrale 2977, me vendodhje ne Pjetroschan, Koplik, Shkoder ne nje siperfaqe totale prej 15595 m2. Pasuria eshte ne pronesi te shoqerise.


Kordinatat ku zhvillohet aktiviteti jane si me poshte:

Koordinata Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4

Nr.	Y (E)	X (N)
1.	4366892.26	4682282.52
2.	4366833.94	4682216.96
3.	4366774.97	4682263.45
4.	4366845.61	4682328.16
5.	4366874.45	4682303.45
6.	4366938.10	4682381.72
7.	4366974.68	4682332.22
8.	4366963.93	4682220.64
9.	4366952.64	4682225.25

Koordinata KRGJSH

Nr.	Y (E)	X (N)
10.	449271.69	4681070.59
11.	449214.15	4681004.37
12.	449154.65	4681050.15
13.	449224.51	4681115.67
14.	449253.63	4681091.31
15.	449316.35	4681170.16
16.	449353.50	4681121.25
17.	449344.07	4681009.57
18.	449332.73	4681014.05



## **Pershkrimi Teknik**

### **Kompostimi I mbetjeve bio**

Kompostimi është proces biologjik apo dekompozim i materies organike (materie organike e vlefshme dhe e fortë, mbetje nga ushqimi si lëvore të frutave dhe perimeve, mbetje nga kopshti, letër, karton, etj), të cilat përmes mikroorganizmave në prani të oksigjenit dhe në kushte të kontrolluara (sipas temperaturës së caktuar dhe lagështisë) krijon kompostin, sasi kjo materiali e ngjajshme me humusin (pleh organik).

Kompostimi është material organik që mund të shtohet në tokë për të ndihmuar bimët të rriten. Kompostimi thjesht përshpejton procesin duke siguruar një mjedis ideal për bakteret, kërpudhat dhe organizmat e tjerë të dekompozuar (të tilla si krimbat, bujtinat dhe nematodat) për të bërë punën e tyre. Lënda e dekompozuar që rezulton, e cila shpesh përfundon të duket si tokë pjellore e kopshtit, quhet kompost.

Shoqeria MEIA do të kryej kompostim vetëm të mbetjeve bimore që dalin nga zhvillimi I aktivitetit të perpunimit të bimeve. Pra mbetjet që do të kompostohen janë çdo masë e njomë dhe pjesë e papërdorur bimore (degë, rrënjë, gjethe, lëvore, etj.)

Instalimi I kompostimit i planifikuar është një fushë kompostimi e hapur dhe e thjeshtë për mbetjet bimore. Qëllimi I kompostimit të mbetjeve është që të prodhohet kompost të një cilësie të mirë për ta përdorur për pleherim. Të gjitha mbetjet bimore nga fabrika do të transportohen në shesh me mjetet që disponon shoqeria. Menyra e kompostimit do të jetë me kavaleta.

Pas një procesi të kontrolluar të kompostimit sipas standarteve ndërkombetare të cilësisë, kompostin do të provohet dhe analizohet rregullisht për kriteret e cilësisë në përputhje me standartet shqiptare dhe ato europiane. Kur të plotësohen kriteret përkatëse të cilësisë kompostit/plehu mund të përdoret për qëllime bujqesore.

Instalimi I kompostimit përbehet nga keto hapësira

- 1- Zona për dorezim
- 2- Sheshi I pritjes të volumeve të para -kompostimit
- 3- Hapësira e magazinimit për kompostin e përfunduar
- 4- Zona e perpunimit
- 5- Zona e kompostimit për zhvillimin e gjithë procesit të kompostimit

Proçeset e përgatitjes së biomasës përfshijnë proçesin e grirjes dhe atë të përzierjes. Ky proçes ka për qëllim zvogëlimin e copave të materialeve me dimensione të mëdha (mbetjet që do të perdoren për kompostim) për të siguruar një material që garanton porozitetin e masës duke favorizuar kontaktin me ajrin të mikroorganizmave që bëjnë proçesin e kompostimit.

Përzierja → Përzierja e lëndëve organike të mbetura është faza e proçesit e domosdoshme për ato materiale që ndryshojnë shumë ndërmjet tyre për nga përmbajtja e lagështisë, dimensionet dhe konsistenca.

Kthimi → Kthimi ka për qëllim oksigjenimin e biomasës, shpërndarjen e nxehtësisë, largimin e lagështisë së tepërt dhe ndihmon në ndarjen e komponentëve të ndryshëm në grumbull. Frekuenca e këtij proçesi është në varësi të drejtë me shkallën e fermentimit të materialit

Maturimi → Ky është vazhdim i fazës aktive të proçesit dhe gjatë kësaj kohe kompostimi kryhet në mënyrë shumë të ngadalëshme. Grumbulli mund të mbahet siç është pa bërë kthimin ose ajrimin e detyruar të tij. Në kompostin përfundimtar nuk dallohen materialet që janë përdorur fillimisht, nuk ka erë ose ka erë të pëlqyeshme të ngjashme me atë të bimësisë nën drurët e pyllit dhe merr ngjyrë të errët.

Në varësi të shkallës së dekompozimit dhe qëllimit të përdorimit, ekzistojnë disa lloje të kompostesh:

Kompost i qëndrueshëm - formohet pas 4-8 muajsh, është i gatshëm për aplikim, është i qëndrueshëm dhe i pastër, ka më pak azot sesa në fazën e mëparshme. Ky kompost mund të përdoret në fusha.

Kompost i pjekur - pas 12 muajsh, komposti është i pjekur dhe i dobishëm për rritjen e kulturave të ndjeshme si një pleh afatgjatë dhe një mjet për të përmirësuar cilësinë e tokës, për të ushqyer bimët dhe për të përgatitur substratin për fidanë.

#### Teknika e kompostimit

Subjekti ka zgjedhur të kryejë proçesin e kompostimit me tekniken me paleta (Kavaleta)

#### Paletat

Në këtë teknikë kompostimi, materiali i kompostueshëm vendoset në rreshta paralel të ndarë nga hapësira të konsiderueshme. Paletat zakonisht bëhen në hapësira të pambuluara dhe bazohen në kombinimin e ajrosjes natyrore me përzierjen mekanike për të siguruar kushtet aerobike.

#### Avantazhet:

- e lehtë për tu realizuar;

- trajton një sasi të konsiderueshme lënde organike;
- nuk ka nevojë për eksperiencë.

Disavantazhet:

- disavantazhi kryesor është hapësira që kërkon, e cila është e madhe;
- në mot të ftohtë, ka nevojë për mbulim që të ruajë temperaturën;
- mund të prodhojë erë të keqe.


**- Përshkrim i mbuleses bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi**

Per nga origjina , perberja dhe vecorite gjeobotanike bimesia e Shqiperise ben pjese ne nenzonen floristike mesdhetare e cila perfshihet ne nje njesi me te madhe, ne zonen holarktike. Ndikim te madh ne zhvillimin e flores mesdhetare ushtroi ftohja e pergjithshme e klimes ne periudhen e pleistocenit dhe akullzimi i fuqishem qe pasoi ate. Tiparet karakteristike te bimesise mesdhetare si per sa i perket vecorive gjeobotanike ashtu edhe perberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale te saj, jane karakteristike edhe per bimesine e vendit tone. Por kushtet konkrete te zhvillimit, sidomos te klimes dhe te relievit kane percaktuar edhe vecorite origjinale te flores se Shqiperise.

E gjithë kjo pasuri floristike i detyrohet vecorive te evolucionit paleogjeografik te Shqiperise dhe sidomos larmise se madhe te klimes, copetimit te theksuar te relievit dhe formave te shumellojshme te tij, formacioneve te shumta shkembore ( gelqerore, magmatike, terrigjene) etj.

Fitocenozat e bimesise barishtore shume te larmishme nga perberja e llojeve, gjenden ne te gjitha zonat fitoklimatike te Shqiperise. Megjithese fitocenozat barishtore nga ana e fizionomise ne pergjithesi duken relativisht te peraferta, ato ndryshojne midis tyre nga perberja floristike ne varesi te faktoreve ekologjike. Me perjashtime te pakta, gati ne te gjitha fitocenozat dhe bashkeshoqerimet barishtore gjenden perfaqesues te familjes graminore ( Graminaceae).

Prona ku zhvillohet projekti eshte e nje karakteri rural ku mbizoteron natyra dhe gjelberimi tipik i zones.



*Foto aktuale te zones*

- **Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij**

Shqiperia eshte shume e pasur me ujera nentokesore. Kjo lidhet me shume faktore, por rol te madh sigurisht luajne sasia e madhe e reshjeve dhe shumellojshmeria e formacioneve shkembore, ne te cilat perhapje te madhe kane formimet karbonatike te pershkueshme nga uji. Ne afersi te zones nuk ka lumenj , liqene .

- **Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer**

Organizmat mikroskopikë në kompost ndihmojnë në ajrosjen e tokës, shpërbërjen e materialeve organike për përdorim të bimëve dhe parandalimin e sëmundjeve të bimëve. Higjiena e mirë e kompostimit nënkupton mbulimin e materialit të freskët të pasur me azot, i cili mund të lëshojë erë nëse ekspozohet në ajër të hapur, me material të pasur me karbon, i cili shpesh nxjerr një erë të freskët dhe të mrekullueshme. Komposti kur i hidhet tokës përmirëson kualitetin e saj duke lehtësuar aktivitetin biologjik të tokës. Njëherësh komposti mund të përdoret si substrakt në prodhimin specieve të ndryshme bimore, si element vitaminoz i kondicionimit të tokës ose si pleh, me kusht që të plotësojë disa standarde ISO të përcaktuara.

Ndikime në ajër mund të përmendim aromën e mbetjeve vetëm në fazën që behen gati për t'iu nënshtuar proceseve të kompostimit. Por siç nënkuptohet, këto shkarkime janë në interval shumë të shkurtrë kohor. Materiali qëndron gjatë gjithë fazës së kompostimit I mbuluar duke mos gjeneruar kështu shkarkime në ajër.

Ky aktiviteti nuk shoqërohet me shkarkime ndotëse në ujërat sipërfaqësor, nëntokësor dhe kanalizime.

Për vetë natyrën e aktivitetit, ai nuk shoqërohet me ndikime negative në tokë. Aktiviteti i kompostimit I produkteve bio nuk shoqërohet me zhurma dhe as vibrime. Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe aktiviteti nuk ndikon në florën dhe faunën e zonës në fjalë. Përkundrazi, me arritjen e prodhimit të kompostit, ai do të përdoret për të plehëruar sipërfaqet e mbjella me bimët e kultivuara. Proceset që do të zhvillohen nga veprimtaria për kompostimin e mbetjeve bio, nuk parashikojnë të gjenerojnë mbetje. Ndërsa mbetje që do të gjenerohen nga punonjësit janë mbetje urbane të cilat do të menaxhohen në bashkëpunim me Njësinë e Qeverisjes Vendore, gjithashtu duke parë infrastrukturën e dobët të menaxhimit të mbetjeve urbane në zonën ku do të zhvillohet veprimtaria, shoqëria ka parashikuar instalimin e kontenerëve me qëllim diferencimin e mbetjeve që në burim.

#### **Përfitimet e kompostimit:**

- Rrit lëndën organike në tokë dhe ndihmon në ndërtimin e strukturës së shëndoshë rrënjore.
- Balancon pH e tokës.
- Bën lëndët ushqyese në tokë më të disponueshme për bimët.
- Devijon mbeturinat e ushqimit nga depozitimet.
- Tërheq krimbat e tokës, të konsideruar si "ricikluesit më të mëdhenj të tokës".
- I bën tokat argjilore të ajrosura në mënyrë që ato të kullojnë më mirë.
- Përmirëson aftësinë e tokave ranore për të mbajtur lagështi dhe për t'i rezistuar erozionit.
- Rrit përmbajtjen e vitaminave dhe mineraleve të ushqimit në një kopsht të pasur me plehra

- **Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis të tilla si ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime si dhe për prodhimin e mbetjeve**

Nepermjet kompostimit zvogëlohet ndotja e tokës për shkak të asgjësimit jo të përshtatshëm të mbeturinave të biodegradueshme në deponi. Zvogëlohet ndotja e ujit si pasojë e rrjedhjeve të

lëngjeve në deponi. Zvogëlohet prodhimi i gazit të metanit në tokë si efekt e dekompozimit të mbeturinave organike pa prani të ajrit brenda tokës.

Ndikime ne ajer mund te permendim aromen e mbetjeve vetem ne fazen qe behen gati per t'iu nenshtuar proceseve te kompostimit. Por sic nenkuptohet, keto shkarkime jane ne interval shume te shkurter kohor. Materiali qendron gjate gjithë fazes se kompostimit I mbuluar duke mos gjeneruar keshtu shkarkime ne ajer.

Ky aktiviteti nuk shoqerohet me shkarkime ndotese ne ujerat siperfaqesor, nentokesor dhe kanalizime.

Per vete natyren e aktivitetit, ai nuk shoqerohet me ndikime negative në tokë.

Aktiviteti kompostim I produkteve bio nuk shoqerohet me zhurma dhe as vibrime.

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe aktiviteti nuk ndikon në florën dhe faunën e zones në fjalë. Përkundrazi, me arritjen e prodhimit te kompostit, ai do te perdoret per te plehëruar siperfaqet e mbjella me bimet e kultivuara.

Proceset që do të zhvillohen nga veprimtaria për kompostimin e mbetjeve bio, nuk parashikojnë të gjenerojnë mbetje. Ndërsa mbetje që do të gjenerohen nga punonjësit janë mbetje urbane të cilat do të menaxhohen në bashkëpunim me Njësinë e Qeverisjes Vendore, gjithashtu duke parë infrastrukturën e dobët të menaxhimit të mbetjeve urbane në zonën ku do të zhvillohet veprimtaria, shoqëria ka parashikuar instalimin e kontenerëve me qëllim diferencimin e mbetjeve që në burim.

**- Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuar**

Gjate fazes normale te zhvillimit te projektit nuk do te kete emetime te gazeve, lengjeve, mbetjeve toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin perreth, floren dhe faunen e zones, burimet ujore.

Persa i perket ndikimit ne peizazhin ekzistues dhe topografine e saj do te zgjas per gjate kohes se kryerjes se aktivitetit.

**- Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te**

Duke njohur teknologjine, operacionet ne terren dhe menyren e kompostimit u indetifikuan ndikimet e mundeshme negative ne çdo receptore - perberes te mjedisit.

**Identifikimi i ndikimeve** – Permes te cilit u percaktua nderveprimi mjedis-projekt i kompostimit dhe u indetifikuan ndikimet e mundshme gjate kesaj faze sipas receptoreve te mjedisit.

**Vleresimi i ndikimeve** – Ekspertet mjedisore te fushave te ndryshme bene perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve . Vleresimi i Sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe perafrohet me objektivist me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

**Shtrirja fizike**- Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinore te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim, p.sh. ndikimi ne toke eshte nje ndikim saktesisht i percaktuar i cili mund te matet , por ne se do te ket erozion te tokes ndikimi rritet ne permasa fizike te siperfaqes se marre per studim.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem). Ne rastin tone kompostimi i mbetjeve medicinale do te zgjase per aq kohe sa do te fundkionoj edhe fabrika e perpunimit te ketyre bimeve. Ndersa te gjitha ndikimet e tjera negative ne mjedis jane te perkoshme, si aromat etj

-**Kthyeshmeria** –Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar ).

-**Rendesia** – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike, objekti ndodhet ne distance te konsiderueshme nga zona me e afert e banuar dhe nuk preket nga zhvillimi i ketij aktiviteti.

- **Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin**

Masat per rigjenerimin e mjedisit do te konsistojne ne:

- a. kryerjen e te gjitha punimeve te domosdoshme momentale rehabilituese, sipas projektit
- b. krijimin e siperfaqeve me mbjellje.
- c. sistemimin e kompostit ne siperfaqen e percaktuar

- **Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis**

**Masat qe do te merren per zhvillimin e aktivitetit konformon mjedisit**

**Toka :**

- Kryerja e aktivitetit brenda siperfaqes se kerkuar per zhvillimin e aktivitetit.
- Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.

Erozioni : Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e instalimit të fushes së kompostimit të mbetjeve.

- Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujërave të shiut.
- Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të sipërfaqes së objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës.
- Mirëmbajtja e sipërfaqes ku do të zhvillohet aktiviteti.

Ajri : Mirëmbajtja e instalimeve dhe mjeteve të transportit sipas kapacitetit mbajtës.

- Mjete me kolaudim optimal.
- Pjesë këmbimi rezervë brenda objektit për raste emergjente.
- Plan veprimi në rast rrjedhjesh.
- Përdorimi eficient i mjeteve motorrike.
- Përdorim i karburanti cilësor.
- Pastrim periodik i sipërfaqes së aktivitetit dhe mjeteve të punës.

Zhurma : Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Puna në objekt do të jetë në orare të kufizuara vetëm kur do të kemi procese të depozitimit dhe transferimit të mbetjeve, procese të cilat nuk zgjasin më shumë se 30 minuta nga momenti i shkarkimit dhe ngarkimit të mjeteve të transportit.

Dobitë nga kompostimi janë të shumta:

- Komposti zëvendëson plehrat minerale dhe pesticidet
- Me kompostim zvogëlohet sasia e mbeturinave në deponi
- Zvogëlon ndotjen nga teprica e përdorimit të mbetjeve bio nga bimët
- Kualiteti mikrobiologjik i kompostit si dhe struktura e tij organike është e madhe, ndërsa prezenca e papastërtive dhe e komponentëve toksike varet nga ndarja e mirë e saj.
- Nga komposti kualitativ me një teknologji të thejshtë me ndihmën e skrrajave përfitohet plehu natyral organik-biologjik, i cili favorizon proceset natyrore të humifikimit në tokë, kurse i përdorur në mënyrë të drejtë, jep rezultate më të mira se plehrat minerale .
- Komposti ka një rëndësi të madhe në bujqësi: si zëvendësim për plehun, pesticidet dhe herbicidet etj.
- Përdorimi në prodhimtarinë bimore
- për kondicionimin e tokës
- për plehërim themelor
- për ri plehrim, dhe si
- mulçim (thërmim)
- Përdorimi në mbrojtjen e bimëve
- për kontrollin e sëmundjeve të bimëve
- për kontrollin e dëmtuesve
- për luftimin e sëmundjeve të bimëve
- për luftimin e dëmtuesve.

#### - **Ndikimet e mundshme në mjedisin nderkufitar ( nëse projekti ka natyrë të tillë)**

Aktiviteti zhvillohet në Pjetroshtan, Shkoder pra brenda territorit të vendit tëne dhe nuk ka ndikime në mjedisin nderkufitar.